

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal

Nr 4, datë 31.03.2023

I mbledhjes së këshillit të bashkisë, e cila zhvillohet në sallën e mbledhjeve në Pallatin e Kulturës “Labëria”(Ora 10¹⁰)


Marrin pjesë :

- | | |
|----------------------|----------------------|
| 1.Brunilda Cani | 18.Evis Allushi |
| 2.Adiola Gjoka | 19.Jerina Dervishaj |
| 3.Ina Islamaj | 20.Ervis Moçka |
| 4.Simo Petromilo | 21.Pëllumb Nezha |
| 5.Ramona Jaho | 22.Anisa Shametaj |
| 6.Brunilda Saliq | 23.Andi Resulaj |
| 7.Eglantina Imeraj | 24.Edlira Kapllanaj |
| 8.Ardian Skëndaj | 25.Istref Dobi |
| 9.Migena Balla | 26.Teki Xhemalaj |
| 10.Grigor Dede | 27.Rozina Kormuzi |
| 11.Asime Feraj | 28.Klearda Rapushi |
| 12.Frosina Qyrdeti | 29.Sulltana Bilbilaj |
| 13.Sokol Kushta | 30.Kasëm Mahmuti |
| 14.Kreshnik Tepelena | 31.Briseida Çakërri |
| 15.Arben Meksi | 32.Elona Toçaj |
| 16.Gentian Hamzaraj | 33.Fatos Rukaj |
| 17.Liljana Breshani | |

Mungojnë :

- 1.Jonela Halili
- 2.Alboren Aliaj
- 3.Julian Bleta

- 4.Lindrit Beqiraj
- 5.Klara Bajaziti
- 6.Roneda Muçaj
- 7.Sulejmën Bubeqi
- 8.Kristaq Meçi
- 9.Rudi Pashaj
- 10.Bujar Osmënaj
- 11.Besian Gega
- 12.Ervis Caushaj
- 13.Edison Kapaj
- 14.Anxhela Aliraj
- 15.Paula Sullaj
- 16.Mujo Shakaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 4/1, datë 31.03.2023

Znj.Migena Balla – Përshëndetje! Siç jeni njohur dhe me materialet erendit të ditës, është i ngjeshur me 12 pika. Kemi qenë në diskutime të vazhdueshme dhe, kemi dhe 2 projektvendime që propozoj të futen në rendin e ditës.

1-Projektvendimi “Për shtesa dhe ndryshime në VKB Nr 87, “ që bën fjalë për shtesë të numrit të punonjësve në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike dhe,

2-Projektvendimi , bazuar në kërkesat e ardhura nga ASHK, për kalimin nga përdorimi në pronësi , të tokës bujqësore.

Në mbledhjen e kryesisë, është dhe një propozim nga Shoqata e Arkitektëve ,për emërtimin e rrugës, me emrin Sami Canaj dhe, një tjetër ndryshim rruge, pra nga atje ku ishte , në një rrugë tjetër, me emrin e Ervehe Çela, të ndryshojë rruga.

Z.Ardian Skëndaj – Është dhe një kërkesë , e përsëritur kjo, nga Klubi i Futbollit “Oriku”.Është kërkesë e përsëritur, për rinovimin e afatit të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës. Financim nuk na kërkon.

Znj.Migena Balla – Hedhim në votim rendin e ditës, me të gjitha shtesat dhe propozimet e bëra. Votohet.

Pro – 32 vota.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Miratohet rendi i ditës me shtesat e propozuara.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal

Nr 4/2, datë 31.03.2023

Z.Ardian Skëndaj – Meqenëse kemi projektvendimet për pastrimin, le të relatohet dhe të diskutohet në fillim nga kryetari i komisionit të financës.

Znj.Migena Balla – Pra, në lidhje me pikën 11 të rendit të ditës, projektvendimin “Për miratimin e mënyrës së realizimit dhe fondit financiar vjetor shtesë, të shërbimit të pastrimit për qytetin e Vlorës dhe njësitë administrative “.

Z.Grigor Dede – Lidhur me kontratat e pastrimit që po përfundojnë, dhe e fundit përfundon në 2 Korrik, jemi të ndjeshëm në lidhje me problemin e pastrimit. Nga diskutimet e bëra në komisione, mendojmë që pastrimi për njësitë administrative të bëhet privat, me kontratë 1-vjeçare, pra të nisim procedurat.

Ndërsa, në lidhje me pastrimin e qytetit , të realizohet nëpërmjet Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, me shtesë të fuqisë punëtore. Ky projektvendim është si kombinim i dy projektvendimeve.

Z.Ardian Skëndaj – Procedurat për njësitë administrative do të bëhet nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike.

Z.Sokol Kushta – Nëqoftëse kujtoheni, kam dy muaj që them , çfarë po bëhet për pastrimin. Pse kujtoheni sot. Të thërritet firma. Të japë llogari bashkia, fillon sezoni turistik.....të shtohet dhe pjesa e karburantit ..Numri i turistëve është shtuar. Çfarë do bëjë ndërmarrja. Pse nuk u thirr firma e pastrimit. Ka marrë lekët...,pse e bën..., pse se bën punën .

Z.Edmond Leka /Drejtor i NSHP- Kontrata e pastrimit për Orikumin, ka përfunduar para disa ditësh. Shërbimi nuk ka munguar dhe, nuk do të mungojë deri në tenderin e ri, për njësinë Orikum. Në datën 1 maj, mbaron dhe kontrata për njësitë Shushicë, Qendër dhe Novoselë. Do bëhen procedurat për prokurim nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike. Si, dhe shërbimi, pastrimi në këto njësi, nuk do mungojë.

Z.Sokol Kushta – Flas për Vlorën. Pse nuk janë marrë masat 2-3 muaj më parë ?

Z.Kasëm Mahmuti – Kisha menduar të flisja, kur të vinte pika në rendin e ditës..., Unë dhe zonja Klearda , buxhetin e kemi miratuar kundër ...ndodhemi në ngërç. Zgjidhja e vetme, është vazhdimi i shërbimit të pastrimit nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike . Nuk e di si do ta pranojnë korrekt kontrollin për këtë shërbim, ndërkohë që , punonjësit bëjnë punë dhe detyrë tjetër....

Kemi për të miratuar sot dhe planin vendor të menaxhimit të mbetjeve .

82% → koeficienti i mbledhjes...Nga llogaritja na janë paraqitur 51 mijë e 100 ton , ndërsa 35 mijë ton, referuar planit vendor. Diferenca është e frikshme...Mbi këtë bazë , është llogaritur fuqia punëtore, volumet e punës...

Nëqoftëse do të kishit një sqarim, Pse është kjo diferencë kaq e madhe ?

-Për efekt të organizimit, të menaxhimit të fondeve, mbajtjes së përgjegjesisë, do të sygjeroja të ngrihej një ndërmarrje e re më vete, me strukturë më vete .. Do të ishte shumë më mirë, në një strukturë të vetme së bashku me gjelbërimin.

E shpreh si propozim, nëqoftëse, do të vlerësohet nga administrata..

Znj.Migena Balla – Fjalën e ka administrata.

Z.Daut Zëraj - Referuar fjalës së zotit Kasëm , pika e fundit,nëqoftëse ne i japim zgjidhje asaj që kemi paraqit në projektvendim....Rëndësi ka që, këshilli do vendosë që pastrimi i qytetit , do të bëhet me bashki, por me drejtori apo sektor mënjanë Qyteti nga bashkia...,janë dy variante. Përsa i përket volumeve, të flasë zonja Arjona.

Znj.Arjona Puka – Ajo që është paraqitur në projektvendim, përsa i përket pyetjes së zotit Kasëm, projekcioni është bazuar në masterplanin e vitit 2021, që ka koeficient të ndryshëm nga strategjia....Janë dy gjëra të ndryshme.

Z.Kasëm Mahmuti – Pa dashur të futem në replika, dua të përmend , 51.100 ton , është identike me po atë shifër që është bërë prokurimi në fillim, para disa viteve , dhe referenca është rregjistri i gjendjes civile.

Janë bërë matje nga bashkia, e mbetjeve. Ka pas dhe peshore. Janë rregjistruar të dhënat ? Pse nuk jepen referencat...Nëse ka, sa janë ?

Znj.Migena Balla – Diskutime të tjera ?

Z.Ardian Skëndaj - Të gjitha këto që tha këshilltari, duhet të merren parasysh në vendimmarrje, në llogaritjen e procedurave të prokurimit.

Të nxirret kostua reale. Duhet ti parashikoni të gjitha. Duhet të kishit filluar me procedurat e prokurimit për njësitë.

Znj.Migena Balla – Pra, kemi dy variante, njësitë administrative privat sipas procedurave dhe, pastrimin për qytetin nga bashkia, sipas propozimit të kryetarit të komisionit të financës.

Kalojmë në votim. Votohet.

Pro – 30 vota.

Kundër – 0 vota.


Abstenim – 2 vota.

Miratohet.

Z.Ardian Skëndaj – Për një projektvendim që erdhi me vonesë dhe nuk u fut në rendin e ditës. Nuk është dokumentacioni i plotë.(për shoqëri aksionere), të vijë dhe ta diskutojmë.

Znj.Frosina Qyrdeti - Të vazhdojmë me rendin e ditës. Të respektojmë dokumentacionin.

Znj.Migena Balla – Janë 3 projektvendime për pastrimin. Vazhdojmë me këto.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 4/3, datë 31.03.2023

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën 10 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit “ Për miratimin e planit vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve, Bashkia Vlorë”. Një pjesë e këshilltarëve janë njofur si dhe nga takimet e konsultimet me KFW. Nga administrata një relacion .

Znj.Arjona Puka – Projektvendimi paraqet politikat e menaxhimit të mbetjeve të ngurta për një periudhë 6-vjeçare. Menaxhimi i mbetjeve, janë të gjitha shërbimet në përgjegjësi të Bashkisë Vlorë si pastrimi i rrugëve, grumbullimi, depozitimi i mbetjeve....Në këtë plan përcaktohet mënyra e organizimit e sistemit të menaxhimit . Kemi bërë takime të ndryshme..

Znj.Migena Balla – Pyetje, diskutime ? –Jo.


E hedhim në votë .(Largohet zonja Evis Allushi)

Pro – 31 vota.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 4/4, datë 31.03.2023

Znj.Migena Balla – Kalojmë në miratimin e projektvendimit “Për shtesë dhe ndryshim në VKB Nr 87, datë 23.12.2022 “Për miratimin e numrit të punonjësve të bashkisë, institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara – 2023”.

Edhe ky projektvendim ka të bëjë me sektorin e pastrimit. Një relacion nga zonja Laura.

Znj.Laura Brinja – Referuar pikës 1 të këtij projektvendimi, quhet e miratuar nga projektvendimi i mëparshëm , kalimi nga sipërmarrje në shërbim të vet.

Sipas pikës numri i punonjësve që shtohet është 150, pranë NSHP -së dhe, në pikën 3 se si do të funksionojë ky sektor pranë Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike.

Znj.Migena Balla – Keni pyetje të tjera? Diskutime?

A thamë që shërbimi i pastrimit në qytet , do të bëhet nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike ?
Ka nevojë për shtesë të numrit, fuqisë punëtore mbas datës 1 korrik.

Z.Kasëm Mahmuti – Nuk e kemi materialin.

(Zoti Kasëm Mahmuti dhe zonja Klearda Rapushi, nuk marrin pjesë në votim)

Votohet.

Pro – 29 vota.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 4/5, datë 31.03.2023

Znj.Migena Balla – Vazhdojmë sipas rendit të ditës, me pikën 1, miratimi i procesverbalit të mbledhjes së këshillit, datë 24.02.2023.

Keni gjë në lidhje me këtë ? – Jo.


Kalojmë në votim.

Pro – 31 vota.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 4/6, datë 31.03.2023

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën 2 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit
“ Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e bashkisë për muajin shkurt 2023”.
Relacion nga administrata ?

Znj.Irena Stasa – Janë 39 familje në kushte të këqija socialekonomike, të ndara në rajone e njësi ,
që përfitojnë ndihmë ekonomike nga të ardhurat e bashkisë.

Znj.Migena Balla – Pyetje, diskutime ? –Jo.


Votohet.

Pro – 31vota.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 4/7, datë 31.03.2023

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën 3 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit
“ Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin shkurt 2023”.

Një relacion nga dministrata ?

Znj.Irena Stasa - Nga fondi i qeverisë , përfitojnë 14 familje ndihmë ekonomike .

Znj.Migena Balla – Kalojmë në votim.

Pro -31 vota.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA V Lorë
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 4/8, datë 31.03.2023

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën 4 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit “Për miratimin e listës për fëmijët e familjeve me probleme të thella social ekonomike, që do të frekuentojnë çerdhet dhe kopshtet me drekë për një periudhë 10-mujore, me të ardhurat e bashkisë”.

Znj.Irena Stasa – Nisur nga kërkesat e disa familjeve në nevojë , me probleme të thella social ekonomike, do të frekuentojnë 3 fëmijë kopshtet dhe 2 fëmijë çrdhet , me drekë për një periudhë 10 – mujore , me të ardhurat e bashkisë.

Znj.Migena Balla – Pyetje, diskutime ? –Jo.


Kalojmë në votim.

Pro – 31 vota.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 4/9, datë 31.03.2023

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën 5 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit “Për miratimin e listës së familjeve dhe individëve, që përfitojnë subvencionin e qirasë në treg të lirë dhe vlerat e subvencionit të qirasë për çdo rast”.

Z.Ardian Skëndaj – Zonja nënkryetare . Më premtuat që do të më jepnit relacion brenda 10 ditëve , në lidhje me ndarjen e banesave sociale me kosto të ulët. Pse s’ka ardhur ky relacion? Kush i mban peng? Pse i mban peng kryetari i bashkisë ...u morr vesh. Më jep përgjigje,jeni në vend të kryetarit të bashkisë.

Se s’kemi paguar subvencion, rritet kostua.

Znj.Aulona Veizi - Ne jemi në proces.

Z.Ardian Skëndaj – Çfarë procesi, sa do të zgjasë . Jeni të detyruar të jepni përgjigje për qytetarët.

Znj.Aulona Veizi – Proces vlerësimi.

Znj.Drita Mustafai - Ky projektvendim, është projektvendimi i parë për vitin 2023, bazuar në ligjin “Për strehimin”, në VKM..., në ligjin “Për vetqeverisjen vendore” dhe Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë. Keni listën bashkëlidhur, relacionin spjegues si dhe Vendimin e Komisionit të Strehimit.

Doja të shtoja tek tabela, tek nummri 7, duhet shtuar ...struktura e apartamentit, duhet sqaruar dhe tek numri 8 , sipërfaqja sipas kontratës....

Znj.Migena Balla – Janë detaje që ti pasqyroni me zbardhjen e vendimit.

Pyetje, diskutime ? – Jo.


Votohet.

Pro -31 vota.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal

Nr 4/10, datë 31.03.2023

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën 6 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit “Për miratimin e tavanëve përgatitorë të të ardhurave për Program Buxhetin Afatmesëm 2024 - 2026”. Një relacion nga administrata.

Z.Daut Zëraj – Program Buxheti Afatmesëm dhe parashikimi i të ardhurave , kanë lidhje , pra të relatoj për të 2 projektvendimet. Në këto 2 projektvendime, janë parashikuar nga administrata , realizimi i të ardhurave për vitin 2024÷2026, duke patur parasysh realizimin e të ardhurave nga viti 2021, 2022 si, dhe planifikimin e buxhetit për vitin 2023 me ndryshimet e nevojshme. Granti i pakushtëzuar, i kushtëzuar ardhur nga qeveriaPër vitin 2022, realizimi i të ardhurave 86%. Nisur nga kjo , është bërë dhe parashikimi për vitin 2025÷2026, duke ju referuar dhe shpenzimeve parashikuar dhe sipas Udhëzimit Nr 6 ...

Në planifikimin e tavanëve , bëhet për të përcaktuar kufijtë maksimal për shpenzimet për çdo program buxhetor , për vitin 2024 ÷ 2026. Ky është hapi i parë. PBA në muajin qershor, të detajuar.

Dua të sqaroj, kur kemi miratuar Program Buxhetin Afatmesëm 2023÷2025, është hequr subvencioni i Ujësjellësit. Ndodh në situatat emergjente, nuk munden të bëjnë procedurat e prokurimit, prandaj e kemi vendosur këtë fond, në këtë material në PBA. Unë mendoj, që ky fond të jetë, për situatat emrgjente. Edhe kjo pjesë e subvencionit të miratohet.Do vazhdojmë më tej procedurat.

Znj.Migena Balla – Pyetje, diskutime ?

Z.Ardian Skëndaj – Subvencioni për Ujësjellësin, do kryhet , kur Ujësjellësi të marrë formën e vet ligjore.

Z.Daut Zëraj – Ky është parashikim.

Znj.Migena Balla - Pyetje, diskutime ? – Jo.


Kalojmë në votim. Votohet.

Pro – 31 vota.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 4/11, datë 31.03.2023

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën 7 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit “Për miratimin e tavanëve përgatitorë për Programin Buxhetor Afatmesëm 2024-2026”.

Keni nevojë për relacion ?

Pyetje , diskutime ? – Jo.

Është i njëjtë me projektvendimin që u relatua.


Kalojmë në votim.

Pro – 31 vota.

Kundër – 0 vota.

Abstenim - vota.

Miratohet .



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 4/12, datë 31.03.2023

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën 8 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit “ Mbi miratimin e Buxhetit Faktit të vitit 2022”.(Buxheti i Pavarur, i Pakushtëzuar, Specifik, i Kushtëzuar). Një relacion nga zoti Daut.

Z.Daut Zëraj – Ky projektvendim ka të bëjë me raportin e monitorimit të buxhetit të vitit 2022. Është paraqitur analiza e realizimit për vitin 2022 si për të ardhurat dhe shpenzimet.

Në vitin 2022 , realizimi nga të ardhurat e veta →87%, realizim më i lartë se çdo vit tjetër. Disa tregues janë tejkaluar, disa kanë mangësi si dhe për tarifat dhe taksat. Bazuar në këto taksa dhe tarifa , të ardhurat janë realizuar mbi 100%.

Përsa u përket shpenzimeve , janë realizuar në shumën 885....mijë ose 73%. Për shkak të vonesës nga prefekti si dhe të procedurave të prokurimit për investimet, në këtë buxhet kemi dhe detyrime të prapambetura si, për energjinë elektrike , disa shpronësime.... I kemi detyrime si dhe detyrime nga kontabilizmi për pastrimin. Në këtë buxhet faktik i llogarisim nga matjet e volumeve, për pastrimin e qytetit...kanë ngel dhe disa detyrime ...

Z.Kasëm Mahmuti - Në këtë pasqyrë evidentohen problematikat si gjithë vitet e tjera. Të ardhurat, janë realizuar dhe tejkaluar. Por ka dhe problematika si, mbledhja e taksës së tokës bujqësore, taksa e ndërtesës/banesës....Ngelemi thjesht tek konstatimi. Po nuk u ndrhy, do të vazhdohet e njëjta gjë. Shpenzimet , realizuar në masën → 47% për investimet. E papranueshme kjo shifër. Ndryshimet e volumeve nuk ndodhën papritur....,kemi shumë kërkesa për vlerën e shpronësimeve. Ç’farë është bërë për ndryshimin e kësaj sate ? Janë të njëjtit tregues që nuk realizohen, si arsimit parauniversitar etj. Buxheti që mbledhim dhe nuk shpenzohet. Nëqoftëse, nuk bëhet një analizë, nëqoftëse s’gjendet zgjidhje

Z.Migena Balla – Pyetje, diskutime ? - Jo.

Kalojmë në votim. (Vjen zoti Fatos Rukaj)

Pro – 32 vota.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 4/13, datë 31.03.2023

Znj.Migena Balla - Kalojmë në pikën 9 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB Nr 1 datë 18.01.2023 “Për buxhetin e bashkisë për vitin 2023”. Një relacion nga administrata .

Z.Daut Zëraj - Edhe ky projektvendim, ka lidhje me projektvendimin që diskutuam. Ka dhe mangësi nga ana jonë. E njëjta gjë ishte dhe për shkollat, për sallën e këshillit...kemi mangësi të përbashkëta. Ky projektvendim , sillet pasi është bërë dhe akt rakordimi me Degën e Thesarit. Bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, fondet kalojnë në vitin pasardhës .Fondet e pakushtëzuara në funksion të programeve dhe të ardhurat dhe granti i pakushtëzuar nga vetë bashkia sipas prioriteteve.

Investimet janë bërë kryesisht në shkolla, në rrugë, në NSHP si, dhe rikontruksioni i pallatit të sportit. Janë paraprakisht një mori makinash për pastrim , në NSHP. Tek ky prjektvendim, duam të bëjmë 2-3 saktësime, do ti paraqes dhe pranë sekretariatit.

-Shuma prej 3478...mijë lekë tek shpenzimet, të kalojë me të ardhurat e veta, shpenzimet nga granti i pakushtëzuar.

-Në NSHP, vlera gabimisht, nga euro duhet në lekë.

-Tek investimet për shkollën “Lef Sallata”, të ulim një shumë prej 9 milion lekë, dhe ta kalojmë për kreditë e buta, ardhur shkresë nga Raiffeisen Bank....këto ndryshime, do të pasqyrohen.

Z.Ardian Skëndaj - Jini seriozë. Po kaloni buxhetin për qytetin, për Vlorën.

Z.Daut Zëraj - Ne kemi marrë përsipër të paguajmë interesat për kreditë e buta, shuma është 9 milion.

Z.Edmond Leka – Si drejtues i institucionit, ndër marrja është në gjendje shumë të keqe. Mjetet shumë të amortizuara. Qyteti është në prag të sezonit turistik. Ne po punojmë me makineritë e reja të Ndërmarrjes së pastrimit. Jemi në gjendje shumë të keqe. Mjetet e parashikuara janë emergjente. Ju lutem e miratoni .

Znj.Edlira Kapllanaj- Zoti Daut. Palestra e shkollës “4 Heronjtë” ,është diçka shumë e madhe , ka talente dhe kampionë. S’ka palestër.Ka qenë prioritet. Çfarë do të bëhet?

Z.Ardian Skëndaj – Shumica e investimeve, nuk janë parashikuar në buxhetin afatmesëm 2023-2025.

Z.Daut Zëraj - Cila s'është parashikuar ?

Z.Ardian Skëndaj – I ke të gjitha të miratuara në buxhetin afatmesëm të dhjetorit.

Z.Daut Zëraj – Normalisht janë, investimet kryesore janë.

Z.Ardian Skëndaj - Shlyerje detyrimesh. Për Qendrën Kulturore, këshilli nuk i miratoi. Kush ju'a miratoi , që i keni kaluar?

Z.Daut Zëraj – Nga këshilli i kulturës.

Z.Klevis Kaso/Drejtor i pallatit të sportit – Meqenëse, në rendin e ditës, është dhe restaurimi i pallatit të sportit...jemi në kushte shumë të këqija, kështu që miratojeni.

Z.Sokol Kushta – Para 10 ditësh, pashë ndeshjen në pallat. Pallati është katastrofë. Skandal. Ka shumë vite që nuk është vënë dorë. Pse është lënë në këtë gjendje? Më kanë thënë nuk ka lekë. Po sot, ku u gjetën lekët...shumë mirë që u gjetën. Kemi diskutuar për “Vlora sport”..Kur doli ky buxhet...Nuk më pëlqen shpejtësia e këtij tenderi, këtij buxheti. Pra, dua përgjigje, nga doli ky buxhet.

Z.Daut Zëraj - Siç e sqarova, janë fonde të trashëguara nga viti 2022. Ne menduam faktin që, ky pallat, në buxhetin e muajit dhjetor, planifikuam vetëm çatinë, sot për të gjithë. Dua të them, duhet hequr dorë nga paragjykimet...bashkia nuk i bën dot.

Z.Klevis Kaso - Zoti Sokol, ka shumë të drejtë. Por, shpesh janë bërë kërkesa nga klubi shumësportësh...Nuk ka dalë llogaria.

Z.Sokol Kushta – Zoti Daut, ju keni ngarkesë. Të pyeta një diskutim më madhor për, “Vlora sport“, keni bërë ndonjë organizim ?

Në buxhetin e vitit 2022 të ngelën 7 miliard dhe, nuk kishe për çatinë..Bëheni sportin.

Znj.Liljana Breshani - Jam pro ndërtimeve, restaurimeve, pro zotit Sokol. Përse, jo, të mos shkojnë këto fonde dhe për palestrën si dhe fondi për kafshët endacake. Për mua, fondi për pallatin , të investohet diku tjetër.

Znj.Migena Balla – Kalojmë në votim.

Pro – 30 vota.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 2 vota.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 4/14, datë 31.03.2023

Znj.Migena Balla – Kalojmë në projektvendimin shtesë “Për kalimin nga përdorimi në pronësi të tokës bujqësore “ për shkresat e ardhura nga ASHK. Një relacion .

Znj.Sonela Haxhiraj – ASHK, me dy shkresat....., në zbatim të ligjit Nr 20/2020 dhe VKM Nr 1182/2022 , ka sjellë një listë prej 12 subjektsh , për kalimin e tokës bujqësore nga përdorimi në pronësi...U vendos të kalohen , kur të vijë i plotë dokumentacioni nga ASHK, sipas pikës 2 , të çdo relacioni të dosjes. Projektvendimi do të hyjë në fuqi kur të plotësohet dosja për secilin subjekt , sipas procedurës.

Znj.Migena Balla – Kalojmë në votim .

Pro – 30 vota.

Kundër – 1 votë.

Abstenim – 1 votë.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 4/15, datë 31.03.2023

Znj.Migena Balla – Janë 2 projektvendime, për emërtime rrugësh(lexon..)

Pra, për ndryshim të emrit të rrugës, në lagjen “Hajro Çakërrri” për zonjën Ervehe Çela.

Keni planvendosjen, relacionin.


Kalojmë në votim.

Pro – 32 vota.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 4/16, datë 31.03.2023

Znj.Migena Balla – Kalojmë në projektvendimin për emërtim rruge z.Sami Canaj , ardhur si propozim nga Shoqata e Arkitektëve. Bashkëlidhur planvendosjen dhe relacionin.


Kalojmë në votim.

Pro – 32 vota.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot


Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 4/17, datë 31.03.2023

Znj.Migena Balla - “ Për rinovimin e afatit të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës së K.F”Oriku”.
Pra, për rinovim afati të anëtarëve të këshillit mbikqyrës, z.Agim Begotaraj dhe z.Arsen Belaj ,
për një afat 4 – vjeçar.

Kalojmë në votim.
Pro – 32 vota.
Kundër – 0 vota.
Abstenim – 0 vota.

Miratohet .



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 4/18, datë 31.03.2023

Znj.Migena Balla – Për shkak të ngarkesës së rendit të ditës, anashkaluam shprehjen e ligjshmërisë, për vendimet e mbledhjes së kaluar.

Z.Simo Petromilo – Shprehja e ligjshmërisë.., 11 vendimet e mbledhjes së kaluar , janë shprehur të ligjshëm nga institucioni i prefektit të qarkut ,Vlorë.

Znj.Migena Balla – Kemi dhe pikën e fundit të rendit të ditës, seancë informuese , për ndryshimet klimaterike dhe situatat mjedisore në teritorin e Bashkisë Vlorë.

Referon zonja Aulona Veizi /ZvKryetare e bashkisë .

Është problem shumë madhor. Kemi ndryshime madhore. Jemi të përballur në situata shumë të vështira, thatësira, përmytje etj. Janë shumë sektorë që preken nga këto ndryshime.

Kemi projeksionet në vite të rritjes së temperaturave për vendin tonë. Sektorë të shumtë janë në rrezik. Gjithë bota është e rrezikuar , sidomos Rusi, Shqipëri, Turqi.

Vlora deri në vitin 2100 – 0,5m është niveli i rritjes së ujit. Duhet të marrim masa. Narta rrezikohet.

Këto ndryshime do të vështirësojnë bujqësinë, burimet nënujore, transportin etj.

Faleminderit.

Znj.Migena Balla – Faleminderit. Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.